



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5253 /2026
Data: 10.06.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2026 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 20.05.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Parku dhe Ujëvara” Hani i Elezit.
3. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kanioni “ Dromjak -Hani i Elezit.
4. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungu i Bungëbutës” në Dromjak - Hani i Elezit.
5. Propozim vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kepi i Gjatë dhe burimi i ujit” Pustenik.
6. Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për pikat e të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Parku dhe Ujëvara”, Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: I kemi ndarë propozim-vendimet për shkak se çdo monument duhet me pasur një vendim në veti e jo me u përfshirë të gjitha me një vendim. Në vitin e kaluar, Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore, së bashku me zyrtarët tanë, ka dalë në terren, kanë eksploruar krejt territorin e komunës dhe i kanë përzgjedhur disa vlera, disa peizazhe natyrore, të cilat potencohen se kanë potencial për mbrojtje ligjore dhe si vlera të trashëgimisë natyrore. Fillimisht ata kanë përzgjedhur tetë vlera të trashëgimisë natyrore, pastaj e kanë reduktuar numrin në pesë. Gjatë debatit publik është hequr edhe një monument natyror, kështu që vendimi final është për katër vlera të trashëgimisë natyrore. Në bazë të ligjit i kemi kryer të gjitha procedurat ligjore, kemi mbajtur debatin publik dhe me ligj kërkohet që fillimisht Ministria për Planifikim Hapësinor të japë pëlqim dhe atë pëlqim e kemi marrë, ndërsa tash duhet Kuvendi Komunal që ta miratojë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “PARKU DHE UJËVARA”, HANI I ELEZIT, QË T’I PËRCILLET KUVENDIT

3. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kanioni” Dromjak - Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “KANIONI DROMJAK” - HANI I ELEZIT, QË T’I PËRCILLET KUVENDIT

4. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungu i Bungëbutës” në Dromjak - Hani i Elezit

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “TRUNGU I BUNGËBUTËS” NË DROMJAK - HANI I ELEZIT, QË T’I PËRCILLET KUVENDIT

5. Propozim-vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Kepi i Gjatë dhe Burimi i Ujit”, Pustenik.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: Pasi bëhet fjalë për ujin në fshatin Laç, të cilin i thonë Gurra, nuk e di a e keni menduar mirë, për arsye se nëse merret vendimi për mbrojtje, aty nuk guxon me prekë kush. Është biseduar shumë herë dhe shpeshherë, për shkak të mungesës së madhe të ujit në Han të Elezit, me u kyçur edhe ai ujë në ujësjellës. Banorë nuk ka atje dhe, nëse jepet pëlqimi nga banorët, do të ketë probleme me këtë vendim. Me më pyetur mua, kështu duhet të mbetet, nuk duhet të preket dhe jam për me mbrojtur natyrën, por mos ndoshta kemi telashe më vonë. I përmendët që ishin tetë; cilat janë hequr?

Nexhmedin Daci thekson: Është një bungë e bungëbutës në fshatin Gorancë, por kemi pasur ankesë për shkak se ka potencuar se do të ndërtojë shtëpi, pastaj janë pishat dhe tjetër s’po më kujtohet. Sa i përket mbrojtjes ligjore, këto janë të shkallës së tretë dhe më shumë kanë të bëjnë me konservim. Nuk është kjo zonë e mbrojtur sikur që shpallen Malet e Sharrit në Brezovicë. Janë disa kufizime e jo striktivisht që asgjë nuk mundet me u bërë aty. Janë të shkallës së tretë dhe kjo është mbrojtje ligjore e përkohshme.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM-VENDIMI PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “KEPI I GJATË DHE BURIMI I UJIT”, PUSTENIK, QË T’I PËRCILLET KUVENDIT

6. Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2025

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: E kam përgatitur një informatë për gjendjen në mjedis për vitin 2025 në Han të Elezit. Meqë jemi të gjithë të këtuhit, i dimë pak a shumë burimet e ndotjes, siç është industria, qarkullimi i madh i automjeteve, përdorimi në masë të madhe i masës drusore gjatë dimrit për ngrohje. Në tabelë i kam paraqitur rezultatet e ndotjes së ajrit për parametrat ndotës të monoksidit të karbonit, ozonit, dioksidit të sulfurit, grimcave të suspenduara PM10 dhe PM2.5. Rezultatet, në raport me vitin 2024, janë pak më të mira. Për herë të parë në informatë kam paraqitur një tabelë për vlerat mujore të monoksidit të karbonit dhe për grimcat e suspenduara, me qëllim që të shihet për muajt kur nuk ka punuar kompania Sharrcem, për shkak se kur bëhet fjalë për ndotje ia bëjnë me gisht Sharrcem-it dhe nuk i llogarisin këto ndotjet e tjera. Në tabelë mundeni me pa për muajt shkurt, mars dhe prill. Për këta tre muaj, për shkak se e ka ndërruar furrën, fabrika ka qenë jashtë funksionit. Rezultatet janë më të larta se sa në muajt kur punon fabrika, që do të thotë se ngrohja gjatë dimrit me dru dhe qarkullimi i madh i veturave, për shkak se këtu është magjistralja dhe autostrada, por edhe papastërtitë e rrugëve, ndikojnë në cilësinë e ajrit. Po ashtu, e kam paraqitur një tabelë si një lloj krahasimi me qytetet e tjera, si me Prishtinën, e cila i ka dy stacione për monitorim të cilësisë së ajrit, Mitrovicën, Obiliqin, Gjilanin dhe Prizrenin, dhe mundeni me i pa pak a shumë si një lloj krahasimi. Sa i përket ndotjes së tokës dhe ujit, nuk ka përmirësime; situata është e njëjtë. Ju e dini të gjithë se krejt ujërat e zeza derdhen në lumin Lepenc. Te sektori i mjedisit, vazhdimisht inspektorët tanë dalin në terren.

Menduh Vlasi thekson: Po ta analizosh mirë informatën, del se Hani i Elezit është më i pastërti në Kosovë. Tabelarin e fundit, të cilin e ke paraqitur, potencohet se vlera mesatare në Han të Elezit është 13.3, Prishtina IHMK 20, Mitrovica 21.4, Gjilani 17.9, Obiliqi 16.5; vetëm Prizreni është pak më i pastër, e na jemi në top-listë që e kemi ambientin e pastër. Vlera mesatare vjetore është e njëjtë te na, 10.7, pra neve nuk guxon me na u ndi zëri që ambienti është i dobët, i ndotur, dhe vazhdimisht kemi potencuar që pas Obiliqit ambienti më i ndotur është në Han të Elezit. Unë personalisht, jo tash por asnjëherë, nuk i kam besuar as stacionit monitorues, e mos të flasim për atë që është brenda. Ka kohë, qysh në mandatet e kaluara, që me dalë me aparat monitorues jashtë fabrikës dhe që njëzet e katër orë të jetë transparent, në mënyrë që me pa qytetari në vazhdimësi se sa pluhur ka, sa monoksid karboni ka, sa dioksid dhe monoksid sulfuri ka dhe, përderisa nuk është transparente, këto që i mbyllin me derë, për mu janë të pabesueshme. Në informatë diku ke shënuar që inspektorët dalin dhe një ditë oxhaku ka bërë tym të verdhë; në informatë është dashur me shënu se çka ka ndodhur, është dashur me kërku informatë prej kompanisë Sharrcem se pse ka dalë.

Kryesuesi thekson: Për këtë çështje jam interesuar edhe unë, se është fakt që nëpër Facebook lloj personi i papërgjegjshëm, sepse mu më interesoj për shkak se, kur shihet fotografia, me të vërtetë ishte telashe, dhe ju kam parashtruar pyetje personave të cilët punojnë në kompaninë Sharrcem, që do të thotë persona me besim të plotë, dhe ka qenë furra në defekt, e cila për shkak të defektit është sjellë katërdhjetë në orë dhe i ka dëmtuar tullat brenda. Dëmi u ka shkaktuar vetëm fabrikës, por në qoftë se i nin qytetarët duke shkruar dhe duke folur pa e ditë problemin, atëherë ne duhet me shku dhe me mbyll fabrikën. Ne duhet të interesohemi për PM2.5 dhe PM10, për shkak se këto janë më të rrezikshme dhe duhet të mundohemi me i zvogëlu apo me i eliminu krejt.

Menduh Vlasi thekson: Pikërisht këtë të cilën e sqarove është dashur në këtë informatë me u shënu dhe me i shënu arsyet. Për mu janë të pabesueshme dhe sa herë që do t'i merresh te shkolla fillore "Ilaz Thaçi", shumë e pabesueshme më duket, për shkak se në muajin janar ka më pak pluhur, më shumë grimca, se sa kur punon. Unë e kuptoj se në Han të Elezit ndotës janë edhe kamionët, por edhe në muajin janar dhe shkurt ka pasur kamionë dhe automjete të tjera dhe ka pasë vyjt me ra së paku pak. Ekzekutivi vazhdimisht duhet të kërkojë prej Qeverisë që me u vendos një monitorues transparent, por jo te shkolla fillore "Ilaz Thaçi", për shkak se nëse monitoruesin që është te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" e vendos te Alba, me siguri ambienti del sikur me qenë në Brezovicë, sepse nuk shkon pluhuri atje. Vazhdimisht kam kërkuar që ai monitorues të shkojë diku ku bëhet pluhur.

Kryesuesi thekson: Aparatin matës, kur kam qenë në opozitë, jam lodhur duke ju thënë se pse e keni vendosur atje, por aparati kushtojke treqind mijë euro me ia lëvizur vendin. Fatmirësisht që kompania Sharrcem është e interesuar për çështje të ndotjes, për shkak se Qeveria po e monitorojke çështjen e ndotjes, sepse me mbet për neve, tu diskutuar unë dhe të tjerët këtu, bëhet Kandahar, por fati i madh që monitorohet prej nivelit qendror dhe kompania Sharrcem nuk guxon me i kalu limitet.

Menduh Vlasi thekson: Ne jemi ata të cilët mundemi me ia ndalu edhe punën; organizohemi si qytetarë dhe i dalim te dera. Ju e dini që sa vite ka nuk pastrohen gomat e kamionëve, por për shkak të reagimeve në rrjetet sociale dhe në Greqi, kur ishim atje, i pastrojshin gomat. Do të thotë që presioni qytetar e bën të vetën.

Nexhmedin Daci thekson: Për mendimin tim, sa i përket ndotjes, kemi shumë paragjykime. E para e punës, stacioni i monitorimit është sistem amerikan. Unë vetë kam hyrë me drejtorin e shkollës fillore "Ilaz Thaçi" dhe, si sistem, me të vërtetë është i mirë; aparaturë perëndimore nuk ka më të mirë. Por te na ka qenë politikisht ajo kërkesë se hajde bjene diku ku ka pluhur, por nuk shkojnë punët ashtu, për shkak se ajri nuk ka kufij dhe nuk ka mezhdra. Stacioni i monitorimit të ajrit nuk është pa vend, sepse aty i ke nxënësit, pra fëmijët. Është çështje ligjore dhe nuk lejohet pesëqind metra në afërsi të një impianti siç është Sharrcemi me qenë stacioni i monitorimit të ajrit, për shkak se e kemi diskutuar edhe me Ministrinë këtë, dhe ata kanë pranuar që, pasi po insistoni, gjene një lokal, por nuk kemi vend se ku me e vendos, për shkak se më e rëndësishme është me e vendos se ku ka nxënës. Sa i përket rezultateve, nuk është për mos me i vlerësu. Sa i përket te Sharrcemi, kur të kryhet remonti dhe kur të lëshohet fabrika, ndodhin, por kjo informatë është për vitin e kaluar. Inspektorët kanë dalë në vendin e ngjarjes, e kanë njoftuar, e kanë hartuar procesverbalin dhe e kanë njoftuar Ministrinë. Te na është problemi sepse Sharrcemi sa herë politikisht është shfrytëzuar. U përmend Prishtina dhe Obiliqi; unë po ta garantoj njëqind për qind se këto rezultate janë të sakta dhe Prishtinën e ke shumë më të ndotur se sa Hanin e Elezit.

Medina Imishti thekson: Së bashku me punëtorët shëndetësorë e kemi diskutuar që këto, pak a shumë, kanë qenë ndotësit që ka pasur raste të vdekjeve me kancer në Han të Elezit. E kam pasur një raport që nga viti 2013 deri në vitin 2018 kanë qenë 60 raste të vdekjeve me kancer, prej tyre 44 kanë qenë prej kancerit të mushkërive dhe më intereson të di se deri tash a është rritur numri dhe a keni ndonjë raport prej QKMF-së.

Nexhmedin Daci thekson: Kur flasim për këto sëmundje të rënda, normal që ambienti ndikon, por ndikojnë edhe ushqimet, pastaj duhani.

Sevdi Dernjani thekson: Sa i përket numrit dhe statistikave që janë në rritje, po besoj që çdo herë kanë qenë në rritje. Një kërkesë që ia kam parashtruar Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, znj. Fitore Pacolli, ia kam parashtruar pikërisht për vlerësimin e azbestit në komunën e Hanit të Elezit. M'u ka dukur si një çështje serioze dhe ia kam adresuar ministres, dhe ka parashtruar që ne e kemi një ekip dhe ka mundësi që mundemi me nxjerrë në terren, edhe nëse nuk mundemi me eliminuar azbestin, kemi me bërë vlerësimin e azbestit në komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI GJENDJEN NË MJEDIS NË HAN TË ELEZIT PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

7. Të ndryshme

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson: Vandalizmi që ka ndodhur te parku, a është zbuluar dhe a janë marrë masa? Kamerat që janë vendosur janë investim dhe duhet me u parë përmes kamerave.

Sevdi Dernjani thekson: Mundeni me e quajtur si të doni, por e di që është bërë një raport dhe drejtori për shërbime publike me bërë kërkesë, dhe stacioni policor me u marrë me këtë çështje. Sa i përket kamerave, është çështje e policisë me u marrë me çështjen e kamerave.

Kryesuesi thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:55.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

